VENDIM
Nr.127, datë 2.12.2011

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "BALLKAN GREEN ENERGY" SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa "a", nenit 9 dhe 13 pikat 1, germa "d", të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa "g", 5 pika 1, 13 dhe 14 pika 1, të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.12.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "Ballkan Green Energy" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Ballkan Green Energy" sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave.

Në datën 1.11.2011, me shkresën nr.417/1 Prot., rezultoi e paraqitur një ankesë jashtë afatit 2–mujor të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore të ERE-s, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria "Ballkan Green Energy" sh.p.k., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

Ankesa e sipërcituar është jashtë objektit të këtij licencimi dhe nuk prek aspak vendimmarrjen e ERE-s mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë të shoqërisë "Ballkan Green Energy".

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Ballkan Green Energy" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani